



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:054989

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06160310

KPPP.nr. 354/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Eco Clean Corporation” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811341916 dhe seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Gjilan, Hajvali, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Prenku, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Kavaja Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810487159 dhe seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj, km 5, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 29/24 të datës 15.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka me seli në Kaçanik, jashtë seancës, me datë 13.09.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Kavaja Company” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 29/24, i datës 15.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Eco Clean Corporation” Sh.P.K., ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 29/24 të datës 15.01.2024, me të cilin ka lejuar përmbartimin ndaj debitorin “Kavaja Company” Sh.P.K., duke detyruar të njëjtin, që në bazë të dokumentit të besueshëm: faturë nr. 170/2 e datës 18.02.2021, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 819.00 EUR (me shkronja: tetëqind e nëntëmbëdhjetë euro), me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 18.02.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbartimor duke theksuar se propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm është i pa bazuar për faktin se dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit, duke mos u plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 29 dhe 40 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta shfuqizojë.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke shtuar se propozimi për përmbartim është parashtruar në pajtim me dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 29 të LPP-së, ashtu që fatura si dokument i besueshëm është e përshtatshme për përmbartim. Ka shtuar se pas tentimeve për dorëzim fizik të faturës, të njëjtën e ka dërguar përmes email-it të datës 04.01.2024, e që debitori nuk e ka kundërshtuar pranimin e shërbimeve sipas faturës, por nënshkrimin e të njëjtës. Duke qenë se debitori nuk ka paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e paraqitura në prapësim, i ka propozuar gjykatës që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura nr. 170/21 e datës 18.02.2021 në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së për faktin se fatura e lartcekur, nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit tek pranuesi i faturës, e rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është pranuar me rregull nga debitori.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit se fatura e bashkangjitur në propozimin për përmbartim i është dërguar debitorit përmes adresës elektronike, por që në asnjërën prej komunikimeve të

ofruara nga kreditori nuk ka konfirmim të pranimit të faturës nga ana e debitorit, përkatësisht konfirmim të detyrimit që rrjedh nga kjo faturë pasi që debitori, në komunikimin elektronik të datës 05.01.2024, ka kundërshtuar pranimin e faturës nr. 170/21 e datës 18.02.2021.

Nga si më sipër, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 354/24, datë 13.09.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.